



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2878/8 prot

Datë 16.01.2024

V E N D I M

Nr. 57/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.01.2024 me

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EN-BJO” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-83646-10-13-2023, me objekt: “*NSHP, BOJË FOSFORESHENTE*”, me fond limit 3,000,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 26.10.2023 nga autoriteti kontraktor, “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë”.
- Autoriteti Kontraktor:** “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë”, me adresë: Lagjja, Kushtrimi; Rruga “Dervish Hekali”.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “EN-BJO” SHPK, me NIPT (K87217205O), me adresë: Lagjja “Pavarësia”, Bulevardi “Ismail Qemali”, Pallati Nr.458, Hyrja Nr.11, Kati 1, Vlorë
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit*”

publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 05.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.10.2023, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83646-10-13-2023, me objekt: “NSHP, BOJË FOSFORESHENTE”, me fond limit 3,000,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 26.10.2023, nga autoriteti kontraktor, “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë”.

II.2. Në datën 15.11.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “En - Bjo” SHPK	2,128,300 lekë, skualifikuar
2. “Biotek” SHPK	2,174,750 lekë, kualifikuar
3. “Adenis Kastrati” PF	2,391,500 lekë, skualifikuar
4. “Murati” SHPK	2,617,550 lekë, skualifikuar
5. “IDK Konstruksion” SHPK	2,846,000 lekë, kualifikuar

II.3. Operatori ekonomik “En - Bjo” SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshte:

Skualifikohet pasi nuk ploteson piken 2.3.4. Operatori ekonomik te paraqese mostra per te gjithë artikujt e prokuruar ditën dhe oren e hapjes se tenderit per te verifikuar nese mostrat perputhen me specifikimet teknike duke paraqitur moster vetem per bojen e bardhe, me etikete prodhimi ne dt 12/07/2022 dhe etikete skadence ne dt 12/07/2023.

Nuk ploteson piken 2.3.3. Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt - prokurimi duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave objekt - prokurimi duke paraqitur katalog vetem per bojen e bardhe dhe sipas tabelen Karakteristika Teknike te ky katalog shkruhet: E disponueshme e bardhë dhe e verdhë trafiku, duke mos e perfshire bojen e kuqe dhe te zeze.

Nuk ploteson Shtojcen 5 te specifikimeve teknike, eshte kerkuar pesha specifike 1.75 ± 0.10 kg/ltd dhe eshte ofruar $1,60 \pm 0,05$ gr/ml.

II.4. Në datën 16.11.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak në SPE.

II.5. Në datën 20.11.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3628, si dhe nr. protokollit 2878/2023, datë 20.11.2023, e operatorit ekonomik “EN-BJO” SHPK për procedurën e prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EN-BJO” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2878/2 date 21.11.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “EN-BJO” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 490/26 prot, datë 11.12.2023 me objekt: “Vendim ne lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “En – Bjo” [...]” protokolluar me tonën me nr. 2878/3 datë 13.12.2023, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “EN - Bjo” SHPK, ku konstatohet, se ankesa e këtij të fundit është refuzuar.

II.8. Nisur nga arsyet e skualifikimit dhe pretendimet e ankimuesit me anë të shkresës nr.2878/4 prot., datë 28.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor informacion mbi procedurën e prokurimit, si dhe dorëzimin e mostrave të operatorit ekonomik ankimues, konkretisht: “[...] Sa më sipër, referuar arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “EN - Bjo” SHPK, si dhe pretendimeve të këtij të fundit, krahas informacionit të mësipërm, KPP kërkon nga autoriteti juaj të dorëzoni pranë institucionit tonë mostrat e paraqitura për këtë procedurë prokurimi, nga operatori ekonomik “EN - Bjo” SHPK, së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre, procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre, si dhe informacion të hollësishëm në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit. Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i sipërcituar të dorëzohet pranë KPP-së, brenda ditës së nesërme të punës, nga marrja dijani e kësaj shkrese.”

II.9. Me shkresën nr. 1/1 prot, datë 04.01.2024 me objekt: “Dërgohet informacion mbi ankesën e operatorit ekonomik “En - Bjo” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 2878/5 datë 09.01.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor mbi procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi si dhe mostrat e operatorit ekonomik “EN - Bjo” SHPK, të dorëzuara pranë autoritetit kontraktor.

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “EN - BJO” SHPK, se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike, “Skualifikohet pasi nuk ploteson piken 2.3.4 Operatori ekonomik te paraqese mostra per te gjithë artikujt e prokuruar ditën dhe oren e hapjes se

tenderit per te verifikuar nese mostrat perputhen me specifikimet teknike duke paraqitur moster vetem per bojen e bardhe, me etikete prodhimi ne dt 12/07/2022 dhe etikete skadence ne dt 12/07/2023.”, nuk qendron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.4 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.4 Operatori ekonomik te paraqese mostra per te gjithë artikujt e prokuruar ditën dhe oren e hapjes se tenderit per te verifikuar nese mostrat perputhen me specifikimet teknike.

III.1.2. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve teknike”, të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Materialet

Lënda e parë që do të përdoret ne vijëzimin e rrugëve duhet të jetë posaçërisht për të, të ketë sasinë e nevojshme të reflektivitetit dhe qëndrueshmëri . Të gjitha karakteristikat e mësipërme të jenë në përputhje me Standardin European ISO 9001; dhe UNE – EN 1436. Ofertuesi duhet të paraqesë deklaratën e origjinës së materialeve të përcaktuara në specifikimet teknike të mëposhtme si dhe mostrat e materialeve që do të përdori.

Bojë plastike e ftohtë bikomponente e aplikueshme me sprucim, me karakteristika qëndrueshmërie në një kohë më të gjatë dhe për ngarkesa të mëdha dhe të dendura të trafikut dhe një qëndrueshmëri 3000000 deri në 4000000 shkelle automjetesh mbi material. Fusha e përdorimit do të jetë në vijat ndarëse të korsive, ndalim qëndrimit, shkrimeve dhe shigjetave të drejtimit.

Karakteristikat Fiziko-Kimike:

Viskoziteti Brookfield , me metodë UNE 48076, me vlerë të deklaruar max. 105 KU. Koha e Tharjes me vlere < 30 min, me metodë UNE 135202.

Faktori i Ndriçimit me metodë UNE 48073-2, me tolerancë $\beta \geq 0.80$ dhe me vlerë 0.86, klas LF.

Degradimin nga rrezet ultraviolet me metodë EN 1871 (UV-B). Varieteti $\beta \leq 0.05$ x,y brenda zonës për ngjyrën e saj pa anomali sipërfaqësore apo defekte.

Densiteti Relativ me metodë EN-ISO 2811-1, me tolerancë ± 2 % e vlerës së deklaruar dhe me vlerë të deklaruar $p=2.08$ {2.04-2.12}. Rezistenca ndaj alkaneve (aplikimi mbi beton) me metodë EN 1871.

Aplikimi: Boja përpara përdorimit duhet të përziej mirë dhe kushtet atmosferike të jenë në një temperaturë mbi 5 °C. Norma e harxhimit 1.4-2 kg/m² (komponenti A+B+katalizator dhe më pas mikrosfera xhami). Koha e tharjes <30 min. Kontraktori duhet të dorëzojë një sasi prej 1 kg bojë për komponentin A,B dhe 1 kg katalizator, nga të cilat do të përdorë së bashku me specifikimet teknike të fabrikës dhe normat e konsumit dhe garancinë e jetëgjatësisë së vijës së shënuar. Ngjyra duhet të jetë ngjyrë e bardhë (ose e verdhë) puro. Ngjyra pas aplikimit duhet ti rezistojë kohës (e thatë, e lagësht dhe me shi).

Karakteristikat e Mikrosferave të Xhamit :

Indeksi thyes – Klasi A

Maksimumi % e peshuar e rruazave – Rruaza me diametër <1 mm -- Max.20% .

Rezistenca ndaj ujit, acid klorhidrik, klorur kalciumi dhe sulfide natriumi –E kalueshme
 Substanca të rrezikshme—Class I për As, Pb, Sb
 Mikrosferat e Xhamit duhet të kenë performancë sipas standardit EN 1423:2012 + AC:2013

Bojërat e përdorura nuk duhet të absorbojnë graso, Vajra, njolla të asnjë tipi dhe të ketë një përbërje kimike të përshtatshme që edhe në periudhën e mëpasshme nuk duhet të ketë shenja të depërtimit të substancave bituminoze te shtresave asfaltike të rrugës.

Vijëzimi gjatë kohës së tharjes nuk duhet të shkelet nga automjetet. Koeficienti i ashpërsisë (sipas R.R.R Anglez) nuk duhet të jetë më pak se 60 % e sipërfaqes së pavijëzuar.

Kontraktori duhet të dorëzojë një sasi prej 1 kg bojë nga e cila do të përdorë së bashku me specifikimet teknike të fabrikës dhe normat e konsumit dhe garancinë e jetëgjatësisë së vijës së shënuar . Ngjyra duhet të jetë e bardhë (ose e verdhë) puro. Ngjyra pas aplikimit duhet ti rezistojë kohës (e thate, e lagësht, dhe me shi) .

Bojë termoplastike me sprucim :

Pesha specifike: 1.75±0.10 kg/lt

Rrjedhshmeri : 85±5 KU a 25°C

Mbetje te thata: 99% ±1

Rezistenca : Gërryerje= Perfekte/Vaji e Graso= E shkelqyer/ Agjentet Atmosferike= E shkelqyer/ Lende kundër ngrirjes.

Prodhim: 900 gr/m² me një trashësi /peshë rreth 600 micron.

Tharje: Koha e ngurtësimit dhe kalueshmërisë varet nga temperatura e ambientit , nga ajo e sipërfaqjes rrugore dhe trashësia e vijës. Në 25 °C perthahet për 810 minuta dhe është e kalueshme per 12-15 minuta .

Limiti për aplikacionet: Temperatura e ajrit : min 12 °C, MAX 35 °C/ Temperatura në fund : min 12 °C, max 45 °C./ Lagështira relative max 85 %./Lagështira në fund max 3%.

Materiali i magazinuar: 6 muaj ne kontejnerët origjinal të magazinës, hermetizimit të mbulesës dhe në ambientin e freskët dhe tharës në një temperaturë midis +12/+25°C.

III.1.3. Në shtojcën 6 “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit”, të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
	Boje fosforeshente e bardhe	Kg	3790		
	Boje fosforeshente e verdhe	Kg	410		
	Boje e kuqe fosforeshente	kg	400		
	Boje te zeze	kg	400		
	SHUMA				
	TVSh				
	Total				

Afatet e lëvrimit: 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.5. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.6. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo

sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;
ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.1.7. Neni 77 pika 1 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

III.1.8. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresës me nr. 1/1 prot., datë 04.01.2023, protokolluar pranë KPP me nr.2878/5 prot, datë 09.01.2024, konstatohet se bashkëlidhur këtij dokumentacioni është dorëzuar:

- Procesverbali Nr.490/16 prot., datë 26.10.2023, për marrjen e mostrave, nënshkruar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, ndër to edhe operatori ekonomik "En -Bjo" SHPK, si dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.
- Bashkëlidhur gjendet dokumenti i nënshkruar nga KVO me përmbajtje: "Në bazë të udhëzimit nr.3 datë 12.04.2022 "Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura

nga operatorët ekonomikë”, pas verifikimit të mostrave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave rezulton:

[...]

EN-BJO ShPK me Nipt K872172050

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Kualifikohet
1	Bojë fosforeshente e bardhë	kg	5	Jo (e skaduar)
2	Bojë fosforeshente e verdhë	kg	0	Jo
3	Bojë e kuqe fosforeshente	kg	0	Jo
4	Bojë te zezë	kg	0	Jo

[...]

- Foto të mostrës, ku evidentohet data e skandencës: Pro: 12/07/2022; EXP: 12/07/2023

III.1.11. Sa më sipër, referuar kriterit të mësipërm të kualifikimit, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin “*Operatori ekonomik të paraqesë mostra për të gjithë artikujt e prokuruar ditën dhe orën e hapjes së tenderit për të verifikuar nëse mostrat përputhen me specifikimet teknike*”. Ndërkohë në shtojcën 6 “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit”, të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar furnizimin me artikujt *Bojë fosforeshente e bardhë; Bojë fosforeshente e verdhë; Bojë e kuqe fosforeshente dhe Bojë të zezë*.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit, si dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, në procesverbalin e mbajtur në datë 26.10.2023, nga KVO e ngritur pranë autoritetit kontraktor për verifikimin dhe marrjen në dorëzim të mostrave të paraqitura në procedurën e prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në këtë procesverbal është pasqyruar se operatori ekonomik “En – Bjo” SHPK, ka paraqitur mostër vetëm për produktin “Bojë fosforeshente e bardhë” dhe nuk është paraqitur mostër për produktet e tjera, fakt ky i pranuar dhe nga vetë operatori ekonomik në ankesën e tij, ku citon “...s qarojmë AK se në asnjë fabrikë bojërash nuk prodhohen ngjyra të veçanta përveç të bardhës. Çdo bojë e kërkuar me porosi ndërtohet mbi bazën e Bardhë dhe duke i shtuar pigment sipas kërkesës. Qëllimi i paraqitjes së mostrës ka qenë verifikimi i cilësisë së saj dhe kjo bëhet duke gjykuar mbi bazën e bojës, që OE EN – BJO e ka dorëzuar Brenda afatit të kërkuar në DST”.

Pra, sa më sipër, referuar edhe parashtimeve në ankesë, ankimuesi pranon mungesën e paraqitjes së mostrave për të gjithë artikujt.

Në përfundim, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ka vendosur kërkesën për dorëzimin e mostrës për të gjithë artikujt - objekt prokurimi, ndërkohë operatori ekonomik, ashtu siç edhe vetë pranon ka paraqitur mostër vetëm për artikullin ngjyrë të bardhë. Konkretisht këto artikuj janë të ndryshëm në ngjyrë, ku akoma më tej për ngjyrën e bardhë të verdhë dhe të kuqe kërkohet bojë fosforeshente, ndërsa e zeza nuk është kërkuar fosforeshente, pra këto artikuj nuk mund të jenë të njëjtë.

III.1.12. KPP sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u

përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.13. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë fizike dokumentacioni apo mostre dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor. Referuar legjislacionit në fuqi, mostra i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik disponon kapacitete për të siguruar produktin sipas specifikimeve të kërkuara, sidomos në rastin konkret që objekt i prokurimit janë artikuj me një specifikë të veçantë dhe mosrespektimi i specifikimeve teknike të kërkuara do të ndikonte në vënien në funksion të tyre. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “EN - Bjo” SHPK nuk e ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në lidhje me paraqitjen e mostrave.

III.1.14. KPP gjykon, se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

III.1.15. Gjithashtu, Komisioni sqaron, se nëse operatorët ekonomikë do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kanë pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet se “*1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*” Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët

ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se “1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”

III.1.16. Për sa i përket arsyes së skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik ankimues, mbi datën e skadencës, KPP vlen të theksojë, se në mostrën e paraqitur nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është i pamundur evidentimi i datës së skadencës në këtë mostër.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “EN - BJO” SHPK se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “Nuk ploteson piken 2.3.3, Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt - prokurimi duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave objekt prokurimi duke paraqitur katalog vetem per bojen e bardhe dhe sipas tabelen Karakteristika Teknike te ky katalog shkruhet: E disponueshme e bardhë dhe e verdhë trafiku, duke mos e përfshirë bojen e kuqe dhe te zeze. Nuk ploteson Shtojcën 5 te specifikimeve teknike, eshte kerkuar pesha specifike 1.75 ± 0.10 kg/ltd he eshte ofruar $1,60 \pm 0,05$ gr/ml.”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.3, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt - prokurimi duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave objekt - prokurimi.

III.2.2. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve teknike”, të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Materialet

Lënda e parë që do të përdoret në vijëzimin e rrugëve duhet të jetë posaçërisht për të, të ketë sasinë e nevojshme të reflektivitetit dhe qëndrueshmëri . Të gjitha karakteristikat e mësipërme

të jenë në përputhje me Standardin European ISO 9001; dhe UNE – EN 1436. Ofertuesi duhet të paraqesë deklaratën e origjinës së materialeve të përcaktuara në specifikimet teknike të mëposhtme si dhe mostrat e materialeve që do të përdori.

Bojë plastike e ftohtë bikomponente e aplikueshme me sprucim, me karakteristika qëndrueshmërie në një kohë më të gjatë dhe për ngarkesa të mëdha dhe të dendura të trafikut dhe një qëndrueshmëri 3000000 deri në 4000000 shkelje automjetesh mbi material. Fusha e përdorimit do të jetë në vijat ndarëse të korsive, ndalim qëndrimit, shkrimeve dhe shigjetave të drejtimit.

Karakteristikat Fiziko-Kimike:

Viskoziteti Brookfield , me metodë UNE 48076, me vlerë të deklaruar max. 105 KU. Koha e Tharjes me vlere < 30 min, me metodë UNE 135202.

Faktori i Ndrëçimit me metodë UNE 48073-2, me tolerancë $\beta \geq 0.80$ dhe me vlerë 0.86, klas LF.

Degradimin nga rrezet ultraviolet me metodë EN 1871 (UV-B). Varieteti $\beta \leq 0.05$ x,y brenda zonës për ngjyrën e saj pa anomali sipërfaqësore apo defekte.

Densiteti Relativ me metodë EN-ISO 2811-1, me tolerancë ± 2 % e vlerës së deklaruar dhe me vlerë të deklaruar $p=2.08$ {2.04-2.12}. Rezistenca ndaj alkaneve (aplikimi mbi beton) me metodë EN 1871.

Aplikimi: Boja përpara përdorimit duhet të përzihet mirë dhe kushtet atmosferike të jenë në një temperaturë mbi 5 °C. Norma e harximit 1.4-2 kg/m² (komponenti A+B+katalizator dhe më pas mikrosfera xhami). Koha e tharjes <30 min. Kontraktori duhet të dorëzojë një sasi prej 1 kg bojë për komponentin A,B dhe 1 kg katalizator, nga të cilat do të përdorë së bashku me specifikimet teknike të fabrikës dhe normat e konsumit dhe garancinë e jetëgjatësisë së vijës së shënuar. Ngjyra duhet të jetë ngjyrë e bardhë (ose e verdhë) puro. Ngjyra pas aplikimit duhet ti rezistojë kohës (e thatë, e lagësht dhe me shi).

Karakteristikat e Mikrosferave të Xhamit :

Indeksi thyes – Klasi A

Maksimumi % e peshuar e rruazave – Rruaza me diametër <1 mm -- Max.20% .

Rezistenca ndaj ujit, acid klorhidrik, klorur kalciumi dhe sulfide natriumi –E kalueshme

Substanca të rrezikshme—Class 1 për As, Pb, Sb

Mikrosferat e Xhamit duhet të kenë performancë sipas standardit EN 1423:2012 + AC:2013

Bojërat e përdorura nuk duhet të absorbojnë graso, Vajra, njolla të asnjë tipi dhe të ketë një përbërje kimike të përshtatshme që edhe në periudhën e mëpasshme nuk duhet të ketë shenja të depërtimit të substancave bituminoze te shtresave asfaltike të rrugës.

Vijëzimi gjatë kohës së tharjes nuk duhet të shkelet nga automjetet. Koeficienti i ashpërsisë (sipas R.R.R Anglez) nuk duhet të jetë më pak se 60 % e sipërfaqes së pavijëzuar.

Kontraktori duhet të dorëzojë një sasi prej 1 kg bojë nga e cila do të përdorë së bashku me specifikimet teknike të fabrikës dhe normat e konsumit dhe garancinë e jetëgjatësisë së vijës së shënuar . Ngjyra duhet të jetë e bardhë (ose e verdhë) puro. Ngjyra pas aplikimit duhet ti rezistojë kohës (e thate, e lagësht, dhe me shi) .

Bojë termoplastike me sprucim :

Pesha specifike: 1.75±0.10 kg/lt

Rrjedhshmëri : 85±5 KU a 25°C

Mbetje te thata: 99% ±1

Rezistenca : Gërryerje= Perfektë/Vaji e Graso= E shkëlqyer/ Agjentet Atmosferike= E shkëlqyer/ Lende kundër ngrirjes.

Prodhim: 900 gr/m² me një trashësi /peshë rreth 600 micron.

Tharje: Koha e ngurtësimit dhe kalueshmërisë varet nga temperatura e ambientit , nga ajo e sipërfaqes rrugore dhe trashësia e vijës. Në 25 °C përthahet për 810 minuta dhe është e kalueshme për 12-15 minuta .

Limiti për aplikacionet: Temperatura e ajrit : min 12 °C, MAX 35 °C/ Temperatura në fund : min 12 °C, max 45 °C./ Lagështira relative max 85 %./Lagështira në fund max 3%.

Materiali i magazinuar: 6 muaj ne kontejnerët origjinal të magazinës, hermetizimit të mbulesës dhe në ambientin e freskët dhe tharës në një temperaturë midis +12/+25°C.

III.2.3. Në shtojcën 6 “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit”, të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
	Boje fosforeshente e bardhe	Kg	3790		
	Boje fosforeshente e verdhe	Kg	410		
	Boje e kuqe fosforeshente	kg	400		
	Boje te zeze	kg	400		
	SHUMA				
	TVSh				
	Total				

Afatet e lëvrimit: 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.5. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të

shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.6. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi

ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.2.7. Neni 77 pika 1 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

III.2.8. Në nenin 40, pika 6 germa b) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

[...]

III.2.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përbushur

nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.10. Në rastin konkret, nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar "*Fletë të dhënash teknike, nga prodhuesi DEUTSCH Color, Straben 80- G*", ku paraqiten karakteristikat teknike të bojës.

Në kriteret e veçanta të kualifikimit në pikën 2.3.3 "*Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt - prokurimi duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave objekt - prokurimi*". Nga verifikimi i katalogut ("*Fletë të dhënash teknike, nga prodhuesi DEUTSCH Color, Straben 80- G*") të paraqitur nga operatori ekonomik "En – Bjo" SHPK, gjykojmë, se në këtë të fundit nuk pasqyrohen të gjitha ngjyrat e kërkuara nga autoriteti kontraktor, pasi në dokumentin "*Fletë të dhënash teknike*", në gjuhën shqipe përcaktohet ngjyra "*E disponueshme e bardhë dhe e verdhë trafiku*". Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues në lidhje me arsyen e skualifikimit se "*Nuk plotëson Shtojcës 5 të specifikimeve teknike, është kërkuar peshë specifike 1.75 ± 0.10 kg/lt dhe është ofruar $1,60 \pm 0,05$ gr/ml*", KPP nga verifikimi i specifikimeve teknike për artikujt e mësipërm, konstaton, se kërkohet *Peshë specifike 1.75 ± 0.10 kg/lt*, ndërkohë referuar katalogut të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, përcaktohet specifikimi teknik *Densiteti (i bardhë) $1,60 \pm 0,05$ gr/ml*.

Referuar arsyes së skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, konstatojmë, se nuk përputhet kërkesa në specifikimet teknike (*Peshë specifike*) të dokumenteve të tenderit me specifikimin teknik (*Densiteti (i bardhë)*) në katalogun e operatorit ekonomik ankimues, specifikim teknik të cilit i referohet autoriteti kontraktor në arsyen e skualifikimit. Për këtë arsye, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor para konstatimit të tij për skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues, duhet të kërkonte sqarime në lidhje me pasqyrimin e specifikimit teknik *Peshë specifike 1.75 ± 0.10 kg/lt*, në katalogun e paraqitur nga operatori ekonomik "En – Bjo" SHPK.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik "En - Bjo" SHPK, qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “En - Bjo” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83646-10-13-2023, me objekt: “NSHP, BOJË FOSFORESHENTE”, me fond limit 3,000,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 26.10.2023 nga autoriteti kontraktor, “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë”.
 2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “En - Bjo” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “En - Bjo” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

